



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2668 Prot.

Tiranë, më 10.5. 2021

U R D H Ë R

Nr. 89, datë 10.5. 2021

PËR

**MARRJEN E MASAVE PËR MBARIMIN E VITIT AKADEMIK 2020-2021
NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

U R D H Ë R O J:

1. IAL-të të marrin masa për mbarimin e vitit akademik 2020-2021 brenda datës 30 shtator të vitit 2021.
2. Në zbatim të rekomandimit të Komitetit Teknik të Ekspertëve, për hapjen e auditorëve në institucionet e arsimit të lartë (IAL) vetëm për konsultime dhe provime, IAL-të të marrin masa për:
 - a) organizimin e punës për zhvillimin e orëve të konsultimit përpara sezonit të provimeve;
 - b) secili prej titullarëve/pedagogëve të programeve lëndore të të gjitha cikleve të studimit, të hartojnë planin e organizimit të konsultimeve me studentët, për secilin program lëndor, bazuar në nevojat për orë konsultimi, sipas specifikave të programit;
 - c) vijimin e mësimdhënies on-line për mbylljen e planeve mësimore në çdo program studimi në të gjitha ciklet e studimit;
 - d) krijimin e kushteve për realizimin në auditorë të provimeve dhe përmbylljen e çdo detyrimi të mbetur për vitin akademik 2020-2021, duke përfshirë edhe ato të diplomimit;
 - e) planifikimin dhe grupimin e prezencës së studentëve në institucion, me qëllim minimizimin e numrit të tyre në auditorë, laboratorë, etj., për respektimin e distancimit social, pastrimin dhe higjienizimin e ambienteve;
 - f) zbatimin e rregulloreve të brendshme, për sjelljen e studentëve në institucion, hyrje-daljet, mbrojtjen e tyre, distancimin social, lëvizjet në institucion, si dhe

higjienizimin dhe dezinfektimin e rregullt të ambienteve, mbi bazën e rregullores së miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik.

3. Institucionet e arsimit të lartë, të hartojnë dhe paraqesin në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë brenda datës 20 maj të vitit 2021, planin e masave organizative dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij urdhri, në të cilin përfshijnë, numrin e saktë të studentëve që planifikohen të frekuentojnë institucionin dhe sipërfaqet në dispozicion të shprehur në m², me qëllim garantimin e distancimit social të studentëve dhe stafit akademik.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EVIS KUSHI

